

NË EMER TË POPULLIT

Më
Dana

06.09.2017
GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni

Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije Brahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR] rruga [REDAKTUAR], Komuna e [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.3020-3/14 e dt.20.08.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të akuzuari, me dt. 03.07.2017 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga [REDAKTUAR], Komuna e [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR], dhe e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të shkollën e mesme i martuar, babë i katër fëmijëve, gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR], i pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

- me datë 04.11.2014, në rruga " Komandant Kumanova ", Komuna e Shtimes, gjatë kontrollit nga ana e punëtorëve të KEDS-it, disstrikti në Ferizaj me qëllim të përvetësimit të kundërligjshme, ka vjedhur energjin elektrike për vete, në atë mënyrë që i dyshuari është furnizuar me energji elektrike përmes një kablllo, në mënyrë të pa autorizuar, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar në njësinorin elektrik me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in disstrikti në Ferizaj në shumë prej 153,32Euro.

Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit të sipërshtetë dhe neneve 4, 7, 41, 42, 43, 46, 49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së,

G J Y K O N

Të akuzuarin [REDAKTUAR], i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 100 Euro të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me kusht me burgim prej tre /3/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj ti paguj dëmin e shkaktuar në shumë prej 153,32 Euro.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale-paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën Ferizaj PP/II.nr.3020-3/14 e dt.20.08.2015 , me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.03.07.2017, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Valdet Avdiu , dhe i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR] ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim ka theksuar se borgjin të dëmtuarës i ka paguar,dhe se kablo më nuk do të vendos jashtë njëisorit elektrik i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të marr për bazë pranimin e fajsisë,më nuk do të përsëritë veprime të tilla.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajsisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajsisë.

Prokurori i shtetit Valdet Avdiu ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajsisë është bërë konform ligjit dhe pranimi korrospodon edhe me

rprovat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njejtin ta pranoj si të till.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vëtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht në procesverbalin nr.171`9299 të datës 04.11.2014, fatura nr.406370,tëe datës 10.11.2014 si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i pa punë ,ka premtuar se më nuk do të përsëris vera të tilla,mbajtës i familjes, pendimin për veprën e kryer, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 100 Euro të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me kusht me burgim prej tre /3/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një (1) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj ti kompenzoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 153,32Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.998/2015 datë 03.07.2017

Zyrtari ligjor
Burim Haxhidema

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

